

ZËRI YNË



ZËRI I DEMOKRACISË

FORMAT E DEMOKRACISË

MUHAMED (15), ANILA (14), ADRIAN (14), ADHURIMI (15), AGONI (15), ELSA (14), SHPËTIMI (15)

Për mënyrën se si ndahet demokracia, lexoni më poshtë artikullin tonë

Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratia“ që nënkupton qeverisje. Demokracia lindi në Greqi në vitin 507 para erës sonë. Në demokraci jemi ne ata që vendosim për shtetin tonë, sepse na lejohet të shprehemi lirshëm. Ne gjithashtu, kemi të drejtë të votojmë në moshën 18 vjeçare. Ne jemi të barabartë pavarësisht gjinisë tonë, racës, kombësisë, fesë etj. Disa prej elementeve të demokracisë janë: paqja, toleranca, sinqeriteti, liria, shprehja e mendimit të lirë, edukimi, respekti, solidariteti dhe të drejtat e njeriut, ku përfshihen edhe të drejtat e fëmijëve. Por, në demokraci nuk lejohet dhuna.


Format më të rëndësishme të demokracisë janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Demokracia e drejtpërdrejtë funksionon në atë mënyrë ku qytetarët marrin vendime në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kurse, në demokracinë përfaqësuese disa individë, të cilët përfaqësojnë qytetarët dhe kërkesat e tyre në përgjithësi, marrin vendime për atë shtet. Këta individë zgjedhen nga qytetarët e atij vendi.

Demokracia përfaqësuese ka dy sisteme: sistemin parlamentar dhe atë presidencial.


Në sistemin presidencial, Presidenti është ai person i cili zgjedhet nga populli, dhe i cili merr vendime në emër të popullit. Ndërsa, sistemi parlamentar udhëheqet nga deputetët, të cilët konsiderohen përfaqësues të atij shteti.



Thënie e rëndësishme



Të gjithë meritojmë të jemi të lirë



Demokracia dhe format e saj



Autorët e artikullit

TË RINJTË FLASIN PËR NDARJEN E PUSHTETIT

DIAMANT (15), DURIM (15), ALTIN (14), EGZON (15), SHKËLQIM (14), SOFIJE (15), ARLINDA (14)



Ne jemi gazetarë të interesuar për udhëheqjen e vendit dhe sot kemi vendosur që t'iu tregojmë mbi njohuritë të cilat i morëm në punëtorinë e demokracisë

Çka është demokracia? Si lindi, si veproi, çfarë sistemi është dhe si funksionon ndarja e pushtetit?

Këto janë disa pyetje të cilat ne do të mundohemi t'iu përgjigjemi në këtë artikull.

Demokracia është sistem i lindur në megapolisin e Athinës, në vitin 507 p.e.s. në qytetërimin e lashtë të Athinës. Si forma të udhëheqjes ekzistonin autokracia (vetëqeverisja) dhe demokracia (udhëheqja e popullit). Edhe Kosova në ditët e sotme udhëheqet përmes sistemit demokratik përfaqësues. Duke u zhvilluar demokracia parlamentare, pushteti filloi të ndahej në mes të institucioneve të demokracisë, duke u krijuar tri degë të pushtetit. Ato edhe sot janë degët e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Sipas bisedës tonë, pushteti legjislativ përfaqësohet nga Kuvendi i Kosovës, i cili detyrë kryesore ka miratimin e ligjeve. Kuvendi i Kosovës përbëhet prej 120 deputetëve apo përfaqësuesve. Ky pushtet është sistem kyç i qeverisjes. Pushtet tjetër i demokracisë është ai ekzekutiv, i cili është mjaft i rëndësishëm për vendin tonë. Ky pushtet është i përfaqësuar nga Qeveria, Presidenti, Policia dhe FSK. Qeveria propozon ligje dhe nene tek Kuvendi për t'u shqyrtuar. Pushteti tjetër është ai gjyqësor, i përbërë nga Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit, dhe Gjykata Supreme. Ne po ashtu kemi edhe Gjykatën Kushtetuese. Roli i këtij pushteti është mbajta e proceseve gjyqësore, të cilat demaskojnë shkeljet e ligjeve të Republikës Parlamentare së Kosovës. Ne mendojmë se këto pushtete duhet të kenë përgjegjësi dhe kompetenca të ndara nga njëra-tjetra, sepse kështu ruhet balanci ndërmjet institucioneve dhe ruhet zhvillimi i demokracisë në vend.



Autorët, gazetarët më të rinjë



Një vizatim i Gjykatës Supreme

ZGJEDHJA ËSHTË PJESË E PËRDITSHMËRISË

MELISA (14), RINESA (15), RIONA (15), FITIM (14), DRILON (14), LINDRIT (15), FESTINA (14), ERON (14)



Mësojeni cili është dallimi midis procesit zgjedhor dhe zgjedhjeve

Zgjedhjet fillojnë që në fëmijëri. Ato janë pjesë e përditshmërisë. Që në fëmijëri ne e zgjedhim shokun/shoqen e shumë gjëra të tjera. Megjithatë, për zgjedhjet që i bëjmë ne mund të krenohemi ose të pendohe- mi, prandaj duhet të zgjedhim me kujdes.

Deri në moshën 18 vjeçare merremi me zgjedhje të vo- gla, e jo shumë të rëndësishme. Por, pas asaj moshe kemi përgjegjësi më të madhe mbi vete, sepse fillojnë sfidat e jetës. Me to fillojnë disa zgjedhje më të rëndë- sishme për ne. Kur jemi më të mëdhenj, konsidero- hemi mjaftueshëm të rritur që të marrim pjesë edhe në procesin zgjedhor. Pra, procesi i votimit është një proces mjaft i rëndësishëm, jo vetëm për votuesin por për të gjithë qytetarët e atij vendi.

Përmes një vote të cilën ne e japim, mund të vulozet e ardhmja jonë. Një votë mund të kryej një punë të ma- dhe. Ajo mund të jetë shkaktare e prishjes së një shteti të tërë, por edhe mund të jetë shkaktare e zhvillimit të një shteti. Ne në Kosovë votojmë për deputetët, kurse ata e zgjedhin apo e votojnë Presidentin e vendit.

Ne si qytetarë, i zgjedhim kryetarët e komunave dhe ne e votojmë si kryetar atë që mendojmë se do të bëj zg- jedhjet e duhura. Andaj, nuk duhet të harrojmë se vota e secilit mund të jetë shkaktare për ndryshim, vetëm se sigurohuni që vota juaj të jetë shkaktare për të mirë. Por, si mund ta dimë ne cilin kandidat duhet ta voto-

jmë?

Ne mendojmë që secili kandidat duhet të ketë tipare të caktuara si: arsimimi, bujaria, ndershmëria, sinqeriteti e shumë tipare të tjera shumë të rëndësishme. Në fund, duhet të zgjedhet ai/ajo që këto tipare i ka vërtetë.

Përveç zgjedhjeve komunale, kemi edhe zgjedhjet par- lamentare në të cilat votojmë për deputetët. Këto zg- jedhje janë zgjedhje të rëndësishme, të cilat ndodhin çdo 4 vjet. E të drejtë vote kanë popullata mbi moshën 18 vjeçare, pa dallim feje apo race.




Autorët e artikullit




Elementet kryesore të demokracisë



Deputeti duke mbajtur fjalim



Të drejtat tona në lidhje me edukimin



Ndarja e përgjegjësi në institucione



Zhvillimi i aktiviteteve në punëtori



Puna në grupe



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Nazim Gafurri“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-9
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë